



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.82/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada anëtarë, me zyrtares e lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Florent Spahija nga Instituti Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në shtylla publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, dhe Koalicioni PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3,100.00 (tremijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme, më datën 04.06.2017, në rrugën kryesore të Drenasit, monitoruesit e tyre kanë hasur në posterin e kandidatit për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA të ngjitur në shtylla publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se Koalicioni PDK-AAK-NISMA ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatit për deputet, në hapësira publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar.

Në përgjigjen në ankesë Koalicioni PDK-AAK-NISMA, të datës 06.06.2017, ka theksuar se hapësira në të cilën janë vendosur posterat e kandidatëve është hapësirë private dhe i takon Kjompanisë “Peshkopia” me pronar Blerim Sinani dhe se vendosja e këtyr eposterave është bërë me pëlqimin e pronarit.

Si provë për të dëshmuar përmirësimet e tyre kanë bashkangjitur një foto nga vendi i caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteritë e kandidatit për deputet nga radhët e Koalicioni PDK-AAK-NISMA janë të vendosura në hapësirat publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase Koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteritë e kandidatit për deputet nga ky subjekt politik është vendosur në shtyllë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.82/2017 më datën 07.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Zyhdi Haziri**

### ***Këshilla Juridike:***

*Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*